




qendra e provimeve


SHIFRA
E NXËNËSIT



PROVIMI I MATURËS DHE PROVIMI PROFESIONAL

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

GUSHT, 2021



* A 1 1 5 1 1 9 5 *



KOHA PËR ZGJIDHJE TË TESTIT ËSHTË 180 MINUTA

Gjatë testit nuk lejohet përdorimi i mjeteve elektronike.

Nxënësi/nxënësjja nuk guxon në asnjë mënyrë ta zbulojë identitetin e vet në test ose t'i drejtohet vlerësuesit në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Testi DUHET të shkruhet LEXUESHËM me laps kimik. Nxënësi/nxënësjja mund të shkruaj me shkronja dore ose shtypi. Nëse shkruan me shkronja shtypi DUHET të theksojë shkronjën e madhe.

Testi përmban detyra të cilat zgjidhen në një rën prej mënyrave në vazhdim:

- duke rrethuar numrin para përgjigjes së saktë
- duke shkruar një përgjigje të shkurtër
- duke shkruar një përgjigje më të gjatë
- duke shkruar një tekst funksional
- duke shkruar ese

Me testin ke marrë edhe **fletën e përgjigjeve** për detyrat me zgjedhje të shumëfishtë.

Nevojitet që në vendin përkatës me kujdes të përshkruash përgjigjet tua.


Detyra do të vlerësohet me zero pikë nëse:

- është e pasaktë
- përgjigjja në detyrë me zgjedhje të shumëfishtë NUK është bart në fletën e përgjigjeve
- është rrethuar ose shkruar edhe përgjigjja e saktë dhe e pasaktë
- përgjigjja/eseja është e palexueshme dhe e paqartë
- përgjigjja/teksti funksional/eseja është shkruar me laps të thjeshtë
- teksti funksional/eseja NUK është shkruar në vendin e paraparë, por vetëm në faqet e parapara për koncept (shkrimi i konceptit nuk është i detyrueshëm)

Nëse gabon, vendos një vijë të kryqëzuar mbi të dhe detyrën zgjidhe përsëri.

Kur ta përfundosh punën, kontrolloji edhe njëherë përgjigjet tua.

Me fat!



FAQE E ZBRAZËT

LEXO TEKSTIN DHE PASTAJ PËRGJIGJU NË PYETJET 1, 2, 3, 4 DHE 5.

Ekspertët thonë se sasia e oksigjenit e prodhuar nga pylli Amazon është në të vërtetë shumë më e ulët. Ata e konsiderojnë mashtrim këtë përkufizim duke marrë parasysh pasojat e vërteta që djegia e pyllit të Amazonës ka në përbërjen e atmosferës sonë.

Giorgio Vecchiano, studiues në menaxhimin dhe planifikimin e pyjeve në Universitetin Shtetëror të Milanos, shkruan në Facebook se Amazona nuk është "mushkëria e botës".

Midis 50 dhe 70% të oksigjenit në Tokë prodhohet nga fotosinteza e algave në oqeanet. Pjesa tjetër nga prairies, nga fushat e kultivuara dhe nga pyjet që rriten shpejt, duke grumbulluar karbon dhe duke lëshuar oksigjen.

Amazona nuk prodhon 20% të oksigjenit në botë (një e dhënë e gabuar edhe në gazetat më prestigjioze). Shifra ndryshon nga 0 deri në 6%: pemët thithin dioksid karboni (CO₂) dhe lëshojnë oksigjen me fotosintezë, por ndërsa ato rriten ata gjithashtu duhet të ruajnë indet e tyre, duke konsumuar oksigjen dhe duke lëshuar CO₂ (si ne).

Sa më e madhe pema, aq më afër bilanci neto është në zero.

Për më tepër, gjethet dhe druri degjenerohen nga bakteret dhe kërpudhat, duke lëshuar më shumë CO₂ dhe duke konsumuar më shumë oksigjen. Si konkluzion, balanca anon fare pak në favor të oksigjenit, dhe në vitet kur shumë pemë vdesin nga shpyllëzimi ose nga thatësira, ai i afrohet zeros".

Philippe Ciais, një studiues në Laboratorin e Shkencave të Klimës dhe Mjedisit, thotë se: Të thuash që Amazona prodhon 20 përqind të oksigjenit tonë është pak e ekzagjeruar. Përqindja është ndoshta 10-12 përqind, duke pasur parasysh që edhe fotosinteza e gjeneruar në oqeanet kontribuon në prodhimin e oksigjenit në planet".

Amazon konsumon pothuajse të gjithë oksigjenin që prodhon

Në realitet, Amazon nuk është një burim i shkëlqyeshëm i oksigjenit, pasi pemët konsumojnë pjesën më të madhe të asaj që prodhojnë përmes fotosintezës. Është një proces natyror që ndodh kur bimët kapin dhe ruajnë energjinë diellore, duke e përdorur atë për të shndërruar dioksidin e karbonit në ajër në molekula sheqeri, për të cilat ushqehen. Oksigjeni është produkti përfundimtar.

Sidoqoftë, kontributi i xhunglës Amazoniane në futjen e oksigjenit në atmosferën globale është "praktikisht zero", sepse sasia e krijuar nga fotosinteza fare pak e tejkalon atë që konsumohet nga mikrobet që dekompozojnë materialin e vdekur të bimës.

Vincent Dubreuil, profesor i gjeografisë në Universitetin e Rennes: "Procesi i dekompozimit të lëndës organike konsumon afërsisht të njëjtën sasi të oksigjenit të prodhuar".

Megjithatë, kjo nuk zvogëlon rolin thelbësor që luan Amazon për biodiversitetin e planetit dhe rregullimin e klimës në Amerikë.

Kush është me të vërtetë përgjegjës për rritjen e prodhimit të oksigjenit në Tokë?

Ekspertët thonë se burimi kryesor i oksigjenit në botë gjendet në oqeanet. Ne duhet të falënderojmë fitoplanktonin, një grup mikroorganizmash bimorë që, duke kryer fotosintezën, sigurojnë ri-oksigjenimin e ujit dhe atmosferës. Kjo familje e mikroorganizmave është përgjegjëse për 50 përqind të të gjitha reagimeve të fotosintezës në planet. Ndër speciet më të rëndësishme janë diatomet dhe coccolitophores.

Diatomet janë prodhuesit kryesorë të oksigjenit. Këta organizma mbledhin energjinë diellore dhe e shndërrojnë atë, përmes fotosintezës, në lëndë organike dhe oksigjen. Popullata diatomaceze dublikohet çdo ditë, duke filluar procesin e fotosintezës. Kur kjo ndodh, ata lëshojnë një dritë që mund të shihet edhe nga hapësira. Shtuar kësaj është se diatomet janë "pastruesit" kryesorë të karbonit atmosferik. Vlerësimet na tregojnë se aktiviteti i tyre fotosintetik prodhon midis 20 dhe 40% të oksigjenit të planetit. Efekti në klimën e tokës është shumë i madh.

Emetimet e CO2 janë kërcënim i vërtetë i shpyllëzimit në Amazon.

Ekspertët argumentojnë se prodhimi i oksigjenit nuk duhet të jetë në qendër të debatit për zjarret në Amazon. Përkundrazi, Giorgio Vacchiano - "Dioksidi i karbonit është shkaku kryesor i efektit të serrës, dhe pasi që ka pak në atmosferë në proporcion, shtimi ose heqja pak është shumë më efektive sesa shtimi ose heqja e pak oksigjenit.

Jérôme Chave, studiuese në Laboratorin për evolucionin e biodiversitetit në Toulouse - "Rreth 15% e dioksidit të karbonit në atmosferë thithet nga pyjet e shiut. Nëse zhdukej, dioksidi i karbonit do të mbetej në atmosferë dhe ndryshimi i klimës do të ishte më i shpejtë".

Pyjet tropikale janë po aq të rëndësishëm sa oqeanet, sepse ato mund të kontribuojnë shpejt në zbatimin e strategjive globale për uljen e emetimeve.

Më në fund, është e rëndësishme të kuptojmë që problemi është në të gjithë botën dhe jo vetëm në Amazon. Ndryshimi i klimës prek të gjitha ekosistemet, por vetëm disa prej tyre kanë degraduar aq shpejt dhe spektakolare sa në pyjet tropikale.

Burimi: <http://shqiptarja.com/lajm/a-eshte-pylli-amazon...>

1. Për çfarë flet ky tekst?

1. Amazon është burim i shkëlqyeshëm i oksigjenit
2. për kërcënimin e shpyllëzimit nga zjarret
3. për mënyrën e prodhimit dhe të konsumimit të oksigjenit
4. për konsumimin e oksigjenit në sistemin e dioksid karbonit

RRETHO NUMRIN PARA PËRGJIGJES SË SAKTË DHE ZGJIDHJEN BARTE NË FLETËN E PËRGJIGJEVE.

1 pikë

2. Në bazë të studimeve në cilin vend kemi prodhimin më të lartë të oksigjenit?

1 pikë

3. Cili është roli i dioksidit të karbonit në atmosferë?

2 pikë

4. Çfarë nënkuptojnë ekspertët me konstatimin: *Sa më e madhe pema, aq më afër bilanci neto i oksigjenit është në zero?*

2 pikë

5. Pranë konstatimit të saktë rretho S, kurse pranë konstatimit të pasaktë rretho P.

Amazon prodhon 20% të oksigjenit.	S	P
Nëse dioksidi i karbonit nuk zhduket nga atmosfera kemi ndryshim të shpejtë të klimës.	S	P
Amazon është “mushkëria e botës”.	S	P

1 pikë

LEXO FRAGMENTIN, PASTAJ ZHVILLO DETYRAT 6, 7, 8 DHE 9.

Në këto e sipër, shkoqiti për së largu nja tridhjetë a dyzet mullinj me erë, që ndodhën në atë fushë, dhe, posa i pa, Don Kishoti i tha shqytartit të tij: nga shërbëtori i tij dhe i tha:

– Fati po na rregullon punët më mirë se çdo t’dëshironim vetë. Se ja, shiko atje, i dashur Sanço Pança, janë shfaqur nja tridhjetë e ca më tepër viganë kolosalë me të cilët kam ndërmend të bëj betejë dhe t’i vras që të gjithë, pastaj do t’i plaçkitim dhe kështu do të nisim të pasurohemi. Se kjo është një luftë e mire dhe një shërbim i lartë që bëjmë përëndisë, duke e spastruar faqen e dheut nga ky xhiblet.

– Ç’viganë? – tha Sanço Pança.

– Ata që shikon atje, - iu përgjigj ustai, - me krahë të gjatë prej afro dy kilometrash.

– Shiko mire imzot, iu përgjigj Sançoja, - se ta që duken atje nuk janë vigan, po mullinj me erë, dhe ata që duken si krahë janë pëlhura, të cilat vërtiten prej erës dhe rrotullojnë gurët e

mullirit.

– Merret vesh, iu përgjigj Don Kishoti, - që s'ke haber fare nga aventura. Ata janë viganë. Po në ke frikë, largohu dhe shko iu fal perëndisë, kurse unë shkoj e hyj në betejë të egër e inegale me ta.

Dhe, duke thënë këto, i ra mamuze Rosinantit pa vënë re klithmat e Sanços, që e siguronte se, pa fjalë, ishin mullinj me erë e jo viganë ata me të cilët gatitej të përpiqej. Po atij i ishte mbushur koka që ishin viganë dhe s'i dëgjonte klithmat e Sanços, as hapte sytë për të shikuar se ç'ishin, ndonëse ishin afruar, por thoshte me zë të lartë:

- Mos ikni, frikacakë e burracakë, se një kalorës i vetëm po ju atakon!

Në këtë mes fryu një erë e lehtë dhe pëlhurat e mëdha nisën të lëvizin. Kur a pa këtë, Don Kishoti thirri:

- Edhe sikur të lëvizni më tepër krahë se ata të viganit Briare prapë do m'a paguani!

6. Cilit drejtim letrar i përket vepra?

1 pikë

7. Personazhet kryesor në këtë fragment paraqiten:

1. tragjik
2. komik
3. fisnik
4. pasionant

RRETHO NUMRIN PARA PËRGJIGJES SË SAKTË DHE ZGJIDHJEN BARTE NË FLETËN E PËRGJIGJEVE.

1 pikë

8. Cilat janë nivelet e leximit të veprës?

1 pikë

9. Rretho numrin pranë cilësisë që mund t'i atribuohet heroit të kësaj vepre dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1. arroganca
2. guximi
3. tjetërsimi
4. frikacak

1 pikë

LEXO FRAGMENTIN NGA «KËNGËT E MILOSAOS» DHE PUNO DETYRËN.

Kënga XXII

Uljem, por së dua të fjë.
Mos e mbyllij ti derjen,
të hinj er e dejtit,
të më ftohinj, si më ftohën
vashëzit mbë të skjalisur,
e dielli i paftes
çë më hin ndër vatërat,
ëmavet i parasten
mon çë shkoi je m'i kuljton.
Vajzën me shtan, e bukur
të dashur u më e pata,
djallj ju lje çë asaj q'i gjet.
Me gare ndër këto shpi
ajo tundën djepëthin,
brez e mua më terjorisën.
Uljem, por s`dua të fjë.
Si drita ndë qiellit,
siu ndë kurm të njeriut,
kur e sheh pa menduar,
ajo shpis i ka hje.
Dit e mia të fanëmira,
mbi dhe të kuljtoneni
si tka rehje e ljumërat,
çë të moçëm fanarosen
para attire çë të ljehen.
Uljem, por së dua të fjë.

10. Cilës etapë të zhvillimit i përket fragmenti i dhënë?

1 pikë

11. Radhiti shkrimtarët e mëposhtëm sipas kronologjisë së paraqitjes së tyre në letërsi:

Honore dë Balzak, Andon Zako Çajupi, Fjodor Dostojevski, Ismail Kadare, Alber Kamy

1 pikë

LEXOJI VARGJET DHE PËRGJIGJU NË PYETJET 12, 13, DHE 14.

Me zjarr ju flas... me zjarr.
Në gjirin tim kam hapur varr...
Që t'i jap shpresë – edhe t'ja marr...

Un'ik liqerit zemërak,
Fatlum dh'i pastër si zëmbak,
Po zemra ime kullon gjak:

Se vijnë-urtuar zogjtë e mi,
Dh'u jap ushqim me dashuri –
Një dashuri për llaftari:

Pa nis, ah! gjirin t'a godas...
Dh'e hap, ah!- gjirin më një ças...
Dh'i nginj, ah! zogjtë - e vdes me gas!...

Ahere helmohet e buçet
Pas mallit tim liqeri i shkret
E rrit tallazin posi det.

Ay e tund, ay e shkund,
Ay e hap sa me të mund,
Gjer mun në gjit, gjer mun në fund.

E shpirtin dyke ma përcjellë,
Më thotë, ah! shih sa 'sht'i fellë
Ky gjir' i em që të pat pjellë...
...Me zjarr ju flas, me zjarr.

12. Në cilën vetë rrëfëhet poezia?

1 pikë

13. Gjeni figurën letrare të:

Personifikimit _____

Krahasimit _____

2 pikë

14. Poezia fillon dhe përfundon me të njëjtin varg: *Me zjarr ju flas... me zjarr.* Çfarë efekti jep:

2 pikë

15. Vetëm njëra nga karakteristikat ka të bëjë me karakterin e Jozef K. tek vepra "Procesi" të Franc Kafka, veçoje atë dhe argumentoje përgjigjen:

është viktimë e sistemit ka problem të rëndësishme jetësore mohon një dashuri tjetër

2 pikë

16. Lexoje fragmentin nga drama Duke pritur Godonë (Samuel Beketi) dhe zhvillo detyrën.

Vladimiri: Pa shiko?

Estragoni: Çfarë? Vladimiri (duke bërë me shenjë) Qafën / -

Estragoni: (duke pare qafën) Nuk shoh gjë. /

Vladimir: Eja këtu! Estragoni vjen në vendin e Vladimirit.

Estragoni: Vërtet. / Vladimiri: Duket mish i gjallë. /

Estragoni: Është vend i litarit. / Vladimiri: Duke u fërkuar pas qafës. /

Estragoni: S'ke ç'i bën. / Vladimiri: Është vendi ku lidhet nyja. /

Estragoni: Është e pashmangshme... Vladimiri: I merret fryma. /

Estragoni: Është normale...

A) Komunikimi në mes të personazheve është:

1. tejet i ngathtë, madje i keq
2. i përsosur dhe plot emocione

RRETHO NUMRIN PARA PËRGJIGJES SË SAKTË.

1 pikë

B) Argumentoje përgjigjen.

1 pikë

17. Si quhet vepra e Ismail Kadaresë në të cilën ka paraqitur në formë artistike folklorin dhe mitologjinë shqiptare?

1. Gjenerali i ushtrisë së vdekur
2. Kështjella
3. Kush e solli Doruntinën
4. Piramida

RRETHO NUMRIN PARA PËRGJIGJES SË SAKTË DHE ZGJIDHJEN BARTE NË FLETËN E PËRGJIGJEVE.

1 pikë

18. Lexo tekstin dhe përgjigju në pyetje.

Sot më vdiq mamaja. Apo ndoshta dje, nuk e di. Mora një telegram nga azili “Nëna vdiq. Varrimi nesër. Ngushëllime të sinqerta. Kjo s’do të thotë asgjë. Ndoshta ka ndodhur dje.”

A) Në cilin rol jepen fjalitë e para të romanit?

1 pikë

B) Çfarë kuptohet me rrëfimin e ndajfoljes nesër?

1 pikë

19. Rretho numrin para formës së shkruar drejtë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1. fyt a fyt
2. fyt –a- fyt
3. fytafyt
4. fyta-fyt

1 pikë

20. Plotësoni formën e drejtë të fjalës së dhënë në fjalitë:

(1. të përbashkët/ të përbashktë), (2. ballë hapur/ ballëhapur), (3, Korrigjimin/ Korigjimin)

1. Kemi një libër _____.
2. Dilte _____ në rrugë.
3. _____ e hartimit do ta bëjmë nesër.

1 pikë

21. Përcaktoni klasën e fjalëve të nënvizuara në fjalinë: Era, që frynte pranë pemëve, bënte që të fërfëllinin vetëm gjethet, pa trazuar fare degët.

1. që: _____

2. pranë: _____

3. vetëm: _____

4. fare: _____

2 pikë

22. Vendosni në numrin shumë grupet emërore të mëposhtme:

1. dokument i vjetër, _____

2. ujë i pastër, _____

1 pikë

23. Rishkruaje tekstin duke respektuar drejtshkrimin.

Kur po kalonin poshtë fenerëve të rrugës K. u përpoq disa herë ti vrojtonte shoqëruesit por nga mënyra si e kishin shtrënguar ishte e vështirë ia kishte ënda ti shihte mirë sepse nuk kishte mundur ti vrojtonte si duhet në gjysmëerrësirën e dhomës duhet të jenë tenor tha me vete.

2 pikë

24. Shkruaj një letër zyrtare (numër: 01- 324) me të cilën grupi letrar “Jehona” në emër të shkollës së mesme “25 Maji” Tuzi, me datë 15 tetor 2020 i drejtohet Qendrës kulturore informative “Malësia” që nëse është e mundur t’ia dhuroj grupit letrar “Jehona” disa bileta falas që të ndjekin shfaqjen e parë të dramës.

Respektoni formën e tekstit, me të gjitha të dhënat e domosdoshme që duhet t’i ketë një LETËR ZYRTARE si dhe respektoni gjuhën standarde.

8 pikë

24. LETRA ZYRTARE

25. Janë dhënë dy tema për hartimin e esesë. Rretho numrin para temës të cilën e ke zgjedhur dhe shkruaje esenë që duhet të ketë nga 250 deri në 300 fjalë.

- Me rastin e zhvillimit të temës, shfrytëzo shembujt relevant/të dhënat dhe argumente qëndrimet personale.
- Respekto kërkesën për numrin e fjalëve +/-10% (vlerësohet punimi që ka 225 deri në 330 fjalë; nëse eseja ka më pak se 225 fjalë NUK LEXOHEM FARE, kurse në fjalën e 330-të NDËRPRITET leximi). Eseja DUHET të shkruhet në fletët e parapara për shkrimin e esesë (eseja e shkruar në fletët e konceptit NUK LEXOHEM).
- Bëj kujdes për saktësinë gjuhësore dhe që teksti të jetë i lexueshëm.

1. “I huaji” A. Kamy

UDHËZIME PËR SHKRIMIN E ESESË:

- Shkruaj tiparet themelore të veprës (autorin, llojin letrar, drejtimin dhe titullin).
- Përshkruaj ngjarjet në roman që ndjekin rrjedhën dhe strukturën e veprës.
- Thekson gjykimin aktin e krimit dhe të dënimit.

2. Të kesh frikë nga njeriu

UDHËZIME PËR SHKRIMIN E ESESË:

- Shprehe mendimin për socializimin në mes njerëzve, përballimin me distancimin fizik dhe vetë ndërgjegjësimin t'a mbrojmë njëri – tjetrin.
- Shkruaj për lidhjen me rrjetet sociale, komunikimin online dhe baraspeshimin verbal-fizik?
- Shkruaj sa jemi të ndërgjegjshëm të jetojmë jetën si më parë, kujt i shërbeu?

13 pikë

